


DEMOKRACIA



SHUMËNGJYRËSHE

DEMOKRACIA ËSHTË E JONA

GENTRIT (11), VALTON (11), DIART (11), LEBIBE (10), ENDRIT (11), ELIZA (11), ALRDINA (11), DIAR (11)



Ne mendojmë që të jetosh në demokraci është shumë mirë. Falë saj, na është dhënë mundësia që sot të jemi gazetarë



Demokracia është formë e qeverisjes, në të cilën udhëheq populli. Shteti udhëhiqet nga përfaqësuesit të cilët i zgjedhim me anë të votës. Demokracia për herë të parë është paraqitur në kryeqytetin e Greqisë që është Athina, në vitin 507 para erës së re. Fjala demokraci rrjedh nga fjalët greke „demos“ që do të thotë popull dhe „kratos“ që do të thotë udhëheqje.

Vlerat e demokracisë janë: liria, paqja, toleranca, liria, etj. Ne si qytetarë kemi gjithashtu të drejta. Disa nga to janë: të shprehemi lirshëm, të votojmë, të arsimohemi, etj.

Dy format më të përhapura të demokracisë janë: demokracia e drejtpërdrejtë dhe ajo përfaqësuese. Demokracia e drejtpërdrejtë është atëherë kur populli i merr vendimet direkt. Kurse, ajo përfaqësuese është kur populli zgjedh udhëheqësit e vet dhe ata marrin

vendime në emër të tij.

Ne mendojmë se për të udhëhequr një shtet, duhet poseduar aftësi menaxhuese. Nëse një udhëheqës nuk i përmbush premtimet që i ka dhënë popullit, atëherë



populli më nuk e voton atë. Populli voton atë i cili është më i drejti dhe i cili nuk refuzon të shtojë vlerat në komunitet. Ju falenderojmë që lexuat artikullin tonë dhe shpresojmë që e keni kuptuar rëndësinë që ka demokracia.



Për një botë më të mirë



Gazetarët e demokracisë

BËJE NDRYSHIMIN DUKE VOTUAR

ARIANIT (11), SARA (11), ENSAR (11), LAURINA (11), PAJTIM (11), ELMEDINA (11), ENIS (12),

SHEMSIJE (12)

Nëse nuk votoni, moralisht ju e humbni të drejtën për t'u ankuar

Ne e dimë se vota është e drejtë e çdo qytetari. Këtë të drejtë mund ta shfrytëzojmë që nga moshën 18 vjeçare, sepse atëherë do të jemi më të pjekur.



Ne nuk jemi të obliguar të votojmë. Ajo është përgjegjësia jonë si qytetarë. Me pjesëmarrjen tonë në procesin zgjedhor, mund të bëjmë ndryshime.

Telekomanda e televizorit, ka nevojë për bateri. Nëse nuk i ka bateritë e mbushura, nuk mund ta ndërrojme kanalën e TV-së, sipas preferencës sonë. Edhe përfaqësuesit tanë, qofshin ata të nivelit lokal apo të atij qendror, kanë nevojë për votat tona. Në këtë rast, votat e qytetarëve marrin rolin e baterive.

Ne në familjet tona bisedojmë shumë me njëri-tjetrin.

Zakonisht vendimet i marrim së bashku. Mirëpo, kur është fjala për pjesëmarrje në procesin zgjedhor, secili anëtar i familjes duhet të vendos vetë. Vota është zgjedhje individuale dhe e fshehtë.

Dy llojet e zgjedhjeve në Kosovë janë kur qytetarët mbi moshën 18 vjeçare votojnë për kryetar të komunës, si dhe për deputetë. Zgjedhja e kryetarit të komunës bëhet përmes zgjedhjeve lokale, ndërsa ato për deputetë, përmes zgjedhjeve qendrore.

E rëndësishme të dini është se kur bëhet zgjedhja e përfaqësuesve, mandati i tyre zgjat 4 vjet. Nga ky fakt, ne kuptuam se zgjedhja jonë duhet të jetë e menduar mirë. Pra, qytetarët kanë të drejtë të votojnë atë të cilin ata dëshirojnë. Megjithatë, e rëndësishme për të gjithë është të zgjedhet më i miri dhe më i besueshmi.



Marrim vendime sepse ne jemi populli



Mos lejoni askënd t'ua imponoj votën. Ajo është e fshehtë. Jeni ju ata të cilët vendosni se kujt dëshironi t'ia besoni votën tuaj të çmuar

Para se të votoni, ndiqni me përpikmëri planprogramet e të gjithë kandidatëve. Vetëm kështu do të dini kë ta votoni

TË DREJTAT E FËMIJËVE RESPEKTOHEN

ANDI (11), EDON (11), ELTON (11), GENESA (11), ARBNORA (10), AULOR (11), AULON (11)



Edhe pse jemi fëmijë, ne gëzojmë shumë të drejta në shtetin tonë demokratik. Të drejtat tona mbrohen edhe me ligj dhe me Kushtetutë

Prej që unë kam lindur, kam qenë pjesë e një familjeje të mrekullueshme. Në familjen time kam të siguruar strehimin, ushqimin, të drejtën për të shprehur opinionet, të drejtën për të luajtur dhe shumë të drejta të tjera. Kur kam arritur moshën 5 vjeçare, unë jam bërë



Zëri im dëgjohet

edhe pjesë e sistemit edukativo-arsimor. Sot jam përfitues i këtij sistemi. Të drejtat që i kam në familje, i kam edhe në shkollë. Kam aq shumë raste ku të drejtat e mia janë respektuar, sa që nuk mund t'i numëroj të gjitha rastet në këtë artikull. Më së shumti vlen të theksohet e drejta e shprehjes së lirë. Kësaj të drejte, aq shumë i jepet rëndësi në shkollë dhe në familjen time, sa që më bën të ndihem person me vlerë dhe me

dinjitet. Po ashtu, asnjë nga nxënësit e klasës sonë nuk mund ta kujtoj as edhe një rast kur është ndjerë i/e diskriminuar, sepse nuk kemi pasur raste të tilla. Kjo dëshmohet nga fakti se të drejtat që ne i gëzojmë, janë duke u respektuar nga të gjithë. I tërë ky respekt rrjedh edhe nga pëmbushja e përgjegjësive, që neve si fëmijë na takojnë.

Me këtë nënkuptojmë se kur unë kam të drejtën e shkollimit, unë duhet të mësoj. Kur unë kam të drejtën për t'u shprehur lirshëm, unë duhet të flas gjëra të vërteta dhe të mira. Kur unë kam të drejtën e familjes, unë duhet të jem i sjellshëm dhe i kujdesshëm me anëtarët e familjes.


Prandaj, ju fëmijë të dashur, meqenëse jeni kaq shumë të privilegjuar nga shteti juaj, mundohuni që të jeni të përgjegjshëm për veprimet të cilat i bëni. Shteti ynë mendon për ne, andaj edhe ne duhet të mendojmë për zhvillimin e tij.



Të lumtur që i kemi të drejtat tona

ROLI I MEDIAS NË DEMOKRACI

ENDRI (11), TAHIR (11), ERZA (11), DJELLZA (11), MEDINA (11), ARMIN (11), BAJRAM (12),
SHKËLQIM (11)



A keni menduar ndonjëherë për rolin e medias në demokraci? Ne nxënësit e SH.F.M.U „Andon Zako Çajupi“ do t'iu tregojmë pikërisht për këtë temë

Përshëndetje, lexues të dashur të kësaj gazeteje. Sot kemi mësuar për demokracinë, median dhe rolin e medias në demokraci. Por, çka është demokracia? Demokracia është formë e qeverisjes, në të cilën shumica e



qytetarëve ushtrojnë sovranitetin e tyre. Në demokraci qytetarët e kanë të drejtën e shprehjes së lirë. Demokracia kështu dallon nga diktatura, sepse në diktaturë qytetarët censurisohen. Kjo do të thotë se mendimet e tyre nuk mund të shprehen, ashtu si shprehen në demokraci. Ndërkaq, media luan rol të madh në demokraci. Përmes medias ne informohemi, por edhe populli mund t'i informojë të tjerët. Informatat mund t'i marrim nga TV, radio, rrjetet sociale, gazetat, filmat, librat, videolojërat, etj. Një ndër mediumet që neve

na pëlqen më së shumti është telefoni. Përmes tij, ne mund të informojmë personat e tjerë. Për rolin e medias në demokraci do ta tregojmë një ngjarje të vërtetë. Ajo fillon kështu: Ishte afuar koha e zgjedhjeve. Që unë të kuptoja më shumë se cilin nga kandidatët do ta zgjedh, është e nevojshme të kërkoj informacione të ndryshme për të. Unë dua të di se çfarë pune dhe profesioni ka ai apo ajo. Mua më duhet të di, po ashtu, se a është i mirë dhe i dobishëm ai/ajo për popullin dhe në fund më duhet të arrij në një përfundim. Në bazë të këtij përfundimi, do ta marrë një ndër vendimet më të rëndësishme. Nga ku e marrë këtë informacion? Pikërisht nga mediumet e ndryshme. Për atë ekzistojnë edhe ato. Në mënyrë që unë dhe qytetarët e tjerë të marrim informata të sakta, të paanshme, të besueshme dhe mëse të nevojshme për një vend demokratik.



Grupi i gazetarëve të vegjël demokratikë



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Andon Zako Çajupi“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VI-3
Website: www.demos-ti.org Vendi: Vushtrri